

In the quest of a “poetic dialect” in Pedro Calderón de la Barca’s work

Abstract: Baroque theatre and the Golden Century of Spanish literature are connected, among other things, with an important and well-known name, that of Pedro Calderón de la Barca (1600-1681) and his masterpiece *La vida es sueño* (1636). However, while there still do not exist translations of his works in Albanian, the very echo of him resonated with the author of the essay through a comparison between such work and the other almost similar work – as far as the title is concerned – that of *Ândra e jetës* (1917) by Ndre Mjedja. The paper, while considering the issues that must be solved by a possible translator of the Spanish author, deals with the construction and finding of a poetic dialect as suggested by Matthew Arnold on translating Homer’s work into today’s languages; in the examination of the poetic expression of Albanian authors etc.

Keywords: poetic vocabulary, Baroque poetics, dream, illusion, reception, cultural translation.

1. Sfondi kërkimor

Përkthimi i një vepre letrare me rëndësi në kulturën burimore, bëhet shpesh ngjarje për kulturën mbërritëse, kjo jo për faktin se përkthehet vepra, por se bashkë me të, në përballje sistimore të dy kulturave, pasurohet mendimi dhe shprehësia në kulturën mbërritëse. Në kulturën shqiptare, ngjarje të tilla kanë qenë pa dyshim të lidhura me receptimin e një kulture dhe një gjuhe. Kështu ka qenë përkthimi i *Iliadës* (1965) së Homerit nga Gjon Shllaku (1923 – 2003) dhe ai i *Odisesë*, (1976), si edhe kryevepra e Dante Alighierit *Komedia Hyjnore* (1965) nga Pashko Gjeçi (1918-2010), shqipërimet e veprave të Shekspirit, apo edhe shqipërimi e, më vonë, përkthimi i *Don Kishotit të Mançës* të Miguel de Cervantes (1547-1616) nga Fan S. Noli (1882-1965) dhe Petro Zheji (1929-2015). Historia e përkthimit dhe e përkthimeve, me të drejtë është bërë pjesë e studimeve të teorisë së letërsisë, letërsisë së krahasuar dhe studimeve letrare, atyre mbi përkthimin dhe vetë historisë së përkthimit në kulturën shqiptare.

Një vëmendje më e thelluar në studimet e përkthimit mund të na zbulojë që variantet përkthimore kanë pasur edhe ato ndikimin e tyre të veçantë. Kështu, kemi filluar të kuptojmë e veçojmë ndikimin e ndryshëm të receptimit të veprës së Miguel de Cervantes, *Don Kishoti i Mançës* nga Fan Noli e Petro Zheji dhe jo larg do të vijojmë të kuptojmë veçoritë e këtij ndikimi sot nga Bajram Karaballi apo historinë e përkthimeve të *Ferrit* të Dante Alighierit që nga përkthimi i parë i tij, ai i Luigi Loreccio-s (1896) deri tek më i fundit i Meritan Spahisë (2019), të cilët i vlejné qoftë historisë së përkthimit shqiptar, qoftë studimit të impaktit dhe receptimit të veprës në lexuesit shqiptarë. Mirëpo, e tjetër natyrë paraqitet qasja ndaj veprave, që ende nuk e kanë filluar historinë e receptimeve të tyre me këtë lexues: është fjala këtu për vepra dhe autorë që nuk janë përkthyer ende, cilësia dhe ndërlikueshmëria e të cilave në sistemin letrar të kulturës burimore vështirësohet në përkthim edhe për shkak të distancës në kohë, periudhës letrare kulturore së cilës i përket ajo si shprehësi. Kemi rastin pra, që njësoj si përkthimi i hekzametrit homerik në gjuhët e kulturat moderne të flasim pikë së pari jo thjesht për një përkthim, por një përkthim kulturor.

Rëndom në këtë pikë, ndërmarrja e përkthimit të një vepre komplekse dhe me rëndësi në kulturën burimore, mund të ndihmohet nga strategjitë e përkthimit të kulturave të tjera. Kultura shqiptare e në lidhje me historinë e përkthimit është e pasur qoftë nga pikëpamja e përshtatjeve, shqipërimeve apo edhe përkthimeve të ardhura nga një gjuhë e dytë.

Një shembull tjetër i përkthimit të veprës së Umberto Eco-s (1932-2016), në fillimet e 90-ës për *Emrin e trëndafil* (1996), nga Donika Omari mund të na sugjerojë se procesi i përkthimit nuk është një qasje e thjeshtë mes dy kulturash, por një ndërmjetësim kulturor, më i shumëfishtë i cili mat kështu mjeshtërinë e ndërmjetësit (përkthyesit) në përkapjen e teksturës së ndërlikuar në gjuhën burimore dhe rindërtimin e sjelljen e saj në gjuhën mbërritëse.

“Për përkthimin e një vepre ku subjekti zhvillohet në një kuvend murgjërish, përkthyesit i duhet të njohë terminologjinë fetare katolike. Për ta rikujtuar, lexova sërish Testamentin e ri dhe pjesërisht të Vjetrin, si dhe pjesë nga letërsia jonë e vjetër. M’u duk me vend të vija në gojën e njërit prej personazheve tragjikë të romanit - heretikut që e djezin në turrën e druve - dialektin shkodran (edhe në original frat Mëhilli flet në dialekt), situata të kujton martirizimin e klerit katolik tek ne. Ndërsa për të dhënë të folurën tuafe të Salvadorit mendova të përzieja ca nga të folmet e shqipes, përfshirë ato të arbëreshëve të Italisë.”¹

1 Shih parathënien e Donika Omarit në U. EKO, *Emri i trandafil*, red. GJ. ZHEJL, përkth. nga origjinali D. OMARI, Sh.b. Elena Gjika, Tiranë, 1996, f. 5. Përkthyesja vë në dukje vështirësitë e përkthimit dhe përdorimin e regjistave, stileve dhe shprehësisë

E mirënjohur në ndihmë të përkthimit dhe përkthyesit është vepra e Matthew Arnold-it, *On Translating Homer*[Mbi përkthimin e Homerit] (1861)². Vepra e poetit dhe profesorit të poetikës në universitetin e Oksfordit i përgjigjet atëherë një shqetësimi sa të teorisë së letërsisë aq edhe të historisë, teorisë së përkthimit dhe vlerësohet ende sot për kontributin teorik dhe praktik në përkthimin kulturor. Matthew Arnold-i (1822 -1888) në 7 leksionet e tij përpiqet të formësojë një strategji të sjelljes në gjuhën angleze të heksametrit epik homerik, dhe për këtë ai merr në shqyrtim, përkthime, rrjedhimisht edhe receptime të pjesshme të Homerit, për të ndërtuar strategji të suksesshme përkthimi.³

2. Në kërkim të një strategjie përkthimi në kulturën shqiptare: shprehësia baroke

Të vijnë tek çështja jonë: më konkretisht, cila do të ishte strategjia e përkthimit të një vepre si *La vida es sueño*, [Jeta është ëndërr] (1636)⁴ e Pedro Calderón de la Barca-s, kur dihet se autori ka një rëndësi dhe peshë në kulturën burimore, atë spanjole, duke qenë një nga figurat më në zë të *Shekullit të artë*⁵ në këtë letërsi, bashkë me Miguel de Cervantes – in (1547-1616), Lope de Vega-n (1562-1635), Tirso de Molina-n (1579-1648), etj.

Ndryshe nga problematika që shtron Matthew Arnold-i në lidhje me përkthimin dhe sjelljen e heksametrit homerik në gjuhët moderne, përkthimi i veprës së Pedro Calderón-it, nuk paraqet vështirësinë e ndërtimit të këmbëve ritmike të të kënduarit antik në gjuhët moderne të sotme, të cilat e kanë humbur këtë cilësi, por krijimin në gjuhën mbërritëse (shqipen) të një shprehësie baroke spanjole, poetikë e cila paraqitet sfiduese për përkthyesin letrar sot.

Po kështu, nëse i referohemi veprës së Matthew Arnold-it - gjithmonë në dobi të gjetjes së një strategjie përkthimi - ai merr në shqyrtim një histori qasjesh e përkimesh të veprës së Homerit me sistemin kulturor

dialektore për të ndërtuar poetikën e origjinalit.

2 M. ARNOLD, *On translating Homer with F.W. Newman's Homeric translation and Arnold's Last words*. London: George Routledge & Sons. 1905, f. 35.

3 Ibid., f. 35-40.

4 P. CALDERÓN DE LA BARCA, *La vida es sueño*, MAXTOR, Rungis Cedex, 2017.

5 *Shekulli i artë* spanjol (*Siglo de Oro*) është emri që i jepet periudhës nga viti 1492 deri në 1659. Data e fillimit të kësaj periudhe përkon edhe me fundin e *Reconquista*-s, udhëtimin e parë të Kristofor Kolombit në Amerikë dhe botimin e gramatikës kastiliane të Antonio de Nebrija-s, të parit studiues të gjuhës kastiljane dhe formuluesit të rregullave të saj; si e para gjuhë romane e pajisur me një gramatikë. 1659-a shënon fundin e *Shekullit të artë* nga pikëpamja politike, megjithëse nga pikëpamja artistike data zakonisht shtyhet më tej, në 1681, kohë që përkon me vitin e vdekjes së shkrimtarit dhe dramaturgut Pedro Calderón de la Barca. Shih: M. Z. BAYÓN, *Breve historia del Siglo de Oro*, Nowtilus, S. L., Madrid, 2010, f. 10.

anglez; po në këtë kontekst dhe synim vepra e Pedro Calderón-it, megjithëse nuk ka pasur histori të mëparshme përkthimi, - në fakt nga autorët e *Shekullit të artë* të letërsisë spanjole (1492 – 1681) vetëm Miguel de Cervantes-i është autori më i përkthyer, edhe pse pjesërisht, - ka pasur histori të pjesshme receptimesh, prej imazhit të formuar të të cilave, mund të ndërtohet e kërkohej një poetikë përkuese në shqip. Ndërsa, nga ana tjetër, vepra e mirënjohur e Miguel de Cervantes-it në mos e plotë dhe e vonë, ka një histori të pasur receptimesh dhe përkthimi i kësaj vepre ka ndikimin e vet në sistemin letrar shqiptar, gjë që lipset konsideruar për format shprehimore e idiomatike të vëna në punë me brumin e shqipes, në përgjigje të shprehësisë burimore spanjole, sidomos duke ditur edhe ndikimin e jehonën që ka Don Kishoti i Mançës tek letërsia shqipe, ku mjafton të përmendim *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* (1973) të Dritëro Agollit (1931-2017),⁶ autorë të tjerë të kësaj periudhe nuk janë përkthyer dhe, rrjedhimisht, kanë një receptim jo të drejtpërdrejtë dhe të kufizuar në shqip.

3. Një histori receptimesh

Historia e receptimeve të pjesshme të veprës, lidhur me autorin e fundit të letërsisë spanjole të *Shekullit të artë* për lexuesin shqiptar paraqitet kryesisht përmes studimeve të caktuara, pasi përkthimi i plotë i veprës mungon. Një nga këto studime është ai i Giuseppe Gradilone-s, i cili në artikullin e tij mbi veprën e Ndre Mjedjes, përfshirë në librin *Studi di letteratura albanese*, me titull *La poesia del Miedia: Svolgimento e modelli letterari* (botuar në Romë, 1960), thekson lidhjet e veprës së Mjedjes me autorë të letërsisë italiane dhe botërore, përfshirë Pedro Calderón-in.⁷ Megjithatë, G. Gradilone përmend vetëm kalimthi ndikimin e Calderón-it në veprën e Mjedjes pa u thelluar në aspektet poetike tekstuale të autorit spanjoll, rrjedhimisht edhe duke mos ndërtuar një qasje tekstuale në lexuesit hipotetike të ardhshëm në gjuhën mbërritëse. Për më tepër, ky studim është botuar në vitet 1960 në Romë dhe në gjuhën italiane, pra, është bërë i njohur vetëm për një grup të kufizuar studiuesish dhe ka pasur pak ndikim në një receptim më të gjerë të Calderón-it në lexuesit shqiptarë.

Një formë receptimi, të pjesshëm do ta gjejmë tek studiuesi Gjergj Zheji, i cili në kuadrin e një “*diskutimi popullor*”⁸, duke riaktivizuar këtë

6 A. NUSHI, «A Comparative Overview Between the Duo Characters of Don Quixote Dela Mancha and the Rise and Fall of Comrade Zylo.» *World Journal of Education and Humanities* 3.1 (2021): 19-30. www.scholink.org/ojs/index.php/wjeh.

7 G. GRADILONE, «La poesia del Miedia: Svolgimento e modelli letterari.» *Studi di letteratura albanese*, Roma, 1960.

8 *Diskutim popullor* - gjatë viteve të regjimit komunist, shpesh sidomos për të paraprirë një miratim apo diskutim pranues të opinionit publik, për ndonjë ligj apo nismë të

temë, duke ofruar një vështrim krahasues midis veprës së njohur të Ndre Mjedjes, *Ândra e jetës*, dhe veprës gati homonime për nga titulli të autorit spanjoll *Jeta është ëndërr*, shpreh mendimin se *Ândra e jetës* është “një poemë pesimiste, në linjën e Calderónit”.⁹ Ky pohim i tij shënon një moment të hershëm të receptimit të Calderón-it në kulturën shqiptare, pavarësisht se ishte fillestar dhe i përgjithshëm dhe aq më tepër i izoluar për një publik studiuesish. Ndërsa polemika që pasoi, e cila më së shumti është e kushtëzuar politikisht, nuk është pjesë e studimit; vëmendja ndaj shprehjes së sipërcituar, e cila që nga koha e shqiptimit, ka hyrë edhe në librat shkollorë parauniversitarë të viteve të mëvonshme, duke e etiketuar veprën e autorit spanjoll, si “*pesimiste*” dhe “*të zyrtë*”¹⁰; shënon edhe një formë më konkrete receptimi të veprës në fjalë edhe pse të deformuar. Vetë vepra e autorit spanjoll është e ndërlikuar si nga vargëzimi, ashtu edhe nga trajtimi filozofik i temës në ndërthurje në të të miteve të kulturës helene, të rimarra e të ritrajuara në një formë origjinale.

Kontributi më i rëndësishëm në receptimin e veprës së Calderón-it vjen nga studimi i Isak Ahmetit, i cili ofron një analizë më të thellë të veprës së autorit spanjoll, krahasuar me atë të Ndre Mjedjes, duke cituar vargje nga vepra *Jeta është ëndërr*. Në artikullin “*Njëmendësia e iluzionit*” (Rilindja, 14 prill 1973), Ahmeti, duke debatuar me Gradilone-n, argumenton se ndryshe nga Calderón-i, për të cilin jeta është “*një iluzion, një ëndërr, një jerm, një hije e zbrazët*,” Mjedja e konsideron jetën si një realitet të prekshëm dhe tokësor.¹¹ E rëndësishme në trajtimin tonë është se studiuesi Ahmeti mbështet argumentin e tij me përkthimin e vargjeve nga monologu dramatik i Segismundit, duke ofruar kështu leximin e parë tekstual të

partisë, nxitej një diskutim i tillë popullor, i cili edhe pse paraqitej i lirë, në më të shumtën e rasteve ishte i manipuluar. Duke iu referuar diskutimit në fjalë, si edhe tematikës së tij, atë veprës së Ndre Mjedjes, ky është paraprirë nga fjalimi i Enver Hoxhës të 7 marsit 1968, ku, ndër të tjera, ndalet tek çështje e tematika të autorëve të Rilindjes shqiptare që nuk përkojnë me metodën materialiste dialektike dhe marksiste - leniniste. Shih për këtë fjalimin Hoxha, E. (1982). Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë. E. HOXHA, *Vepra 37 (nëntor 1967-prill 1968)*, “8 Nëntori” Tiranë, ff. 291- 343.

- 9 K. KODRA, “Për një vlerësim sa më objektiv të veprës së Mjedës”, *Studime filologjike*, viti 23, nr. 1, Tiranë, 1969, ff.165-174. Autorja në këtë punim kundërshton, po ashtu si autorët e tjerë, Gjergj Zhejin, i cili, në prononcimet e tij, në kuadrin e diskutimit popullor, ka shprehur mendimin se *Ândrra e jetës* është një poemë pesimiste, në linjën e Calderón-it.
- 10 ZH. NOVA, A. KALLULLI, F. MALO. *Historia e letërsisë shqiptare 2*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1980, f.153.
- 11 Shih edhe: I. AHMETI, *Letërsia shqipe sipas G. Gradilones, Fjala*, nr. 1, f. 2, Prishtinë, 1971; I. AHMETI, *Ndre Mjeda dhe “Ândra e jetës”, Flaka e vëllazërimit*, f. 20, Shkup, 3 nëntor 1971 dhe f. 20, Shkup, 5 nëntor 1971.
...për Calderón-in jeta është “një iluzion, një ëndërr, një jerm, një hije e zbrazët, kurse Mjeda, i cili e njohu mirë veprën e Kalderonit, e konsideron jetën si njëmendësi, një realitet që shihet e preket, si një e vërtetë tokësore.”

veprës në shqip dhe duke vijuar të njëjtin vlerësim si Zheji për pesimizmin e veprës së Calderón-it. Vlerësim të njëjtë ka edhe studiesja Klara Kodra, e cila, duke kundërshtuar Zhejin, në lidhje me veprën e Mjedjes, e cilëson veprën e Calderón-it si “*dramë të zymtë*.”¹²

Ajo që vihet re në studimet dhe artikujt e autorëve të lartpërmendur është receptimi i pjesshëm e i kufizuar i veprës, i deformuar, si dhe cilësimi përmbledhës i kësaj vepre si pesimiste dhe e zymtë. Për më tepër, kjo kushtëzohet nga:

- Leximi i veprës gjithmonë në qasje me veprën e Ndre Mjedjes dhe, për rrjedhojë, jo me qëllimin e përkthimit e as të interpretimit të saj.
- Kujdesi që në këtë kontekst të vërtetohet origjinaliteti i veprës së autorit shqiptar, jo njohja e përkimeve që vepra e Calderón-it ka, dhe as ndonjë lexim i thellë e veprës së autorit spanjoll.
- Mungesa e njohjes së veprës në origjinal; Mund të hamendësohet leximi në origjinal i veprës nga Giuseppe Gradilone apo edhe nga Gjergj Zheji, por nga vetë analizat e sjella nuk mund të hamendësojmë një lexim të veprës në origjinal nga Klara Kodra e Isak Ahmeti.
- Një vështrim sipërfaqësor i krahasimit të teksteve dhe interpretimit, pa marrë parasysh kontekstin kulturor-gjuhësor dhe ekspresivitetin që gjenerojnë veprat përkatëse.
- Ndikimi që rrethanat politike kanë pasur në receptimin apo leximin kritik të një vepre të kulturës botërore.

Prandaj mund të flasim këtu për një receptim të pjesshëm të sjellë në vëmendje nga studiuesit, rrjedhimisht edhe një lexim e interpretim të rrafshët të veprës në lidhje me shtresat kuptimore dhe shprehësinë që krijon vepra e Pedro Calderón-it në sistemin letrar spanjoll, si edhe në poetikën baroke.

4. Qasja tekstuale ndaj veprës

Vetë vepra e Pedro Calderón-it kërkon tashmë një përkthim që të marrë parasysh rrënjët kulturore, gjuhësore dhe ekspresivitetin e saj, duke reflektuar frymën e *Shekullit të artë* të letërsisë spanjole. Për këtë arsye, ajo që diskutuam më herët si receptueshmëri para përkthimit, shërben për të rilexuar veprën me synimin e përkthimit të saj. Ndërsa receptimi i parë, parapërkthimor ka përvijuar një vlerësim për veprën si *pesimiste*, e *të zymtë*, duke u ndalur tek vargjet më karakteristike të saj, atë të motivimit të vetë titullit *Jeta është ëndërr*/ Jeta është ëndërr

...*Yo sueño que estoy aquí,
destas prisiones cargado;
y soñé que en otro estado*

12 K. KODRA, artikull i cituar, *Studime filologjike*, 1969, f. 170.

*más lisonjero me vi.
¿Qué es la vida? Un frenesí.
¿Qué es la vida? Una ilusión,
una sombra, una ficción,
y el mayor bien es pequeño;
que toda la vida es sueño,
y los sueños, sueños son.¹³...*

Un' ândroj që ktu jam
ktyne burgjesh ngarkue;
e prapë kam ândrue n'nji tjetër gjendje
ma lajkatar vedin me e pa.
Ça âsht jeta ? Nji vrull.
Ça âsht jeta ? Nji iluzion,
nji hije, nji trillim,
dhe ma e madhja e mirë e vogël âsht;
pse gjithë jeta nji ândër âsht,
dhe ândrat, ândra janë.¹⁴

Leximi në tërësinë e veprës, sugjeron tema e problematika të tjera komplekse, që shprehen nëpërmjet një shprehësie po komplekse në kuptimet që ndërton.

4.1. Një model poetik barok në gjuhën mbërritëse: Pjetër Bogdani

Një mënyrë për të përcaktuar strategji përkthimi të një vepre komplekse si *Jeta është ëndërr* e Pedro Calderón de la Barca-s është, ashtu siç sugjeron Matthew Arnold-i në librin e tij *Mbi përkthimin e Homerit*, gjetja e një vepre të një poetike të ngjashme në kulturën mbërritëse dhe modelimi i gjuhës, prozodisë, sipas shprehësisë së ndërtuar në këtë gjuhë, të kësaj vepre.¹⁵ Në këtë studim M. Arnold-i shtyhet më tej, ai kërkon një *dialekt poetik* i cili nuk është thjesht pjesë e vargëzimit të kultivuar anglez, as vetëm i baladave, por kryesisht i kulturës popullore, plot shprehësi, ritme dhe fjalë, plot hollësi të imëta, i aftë të shprehë idetë e jetës, përdorimi i shkathët i të cilave mund të prodhojë një stil jetese të përshtatshëm për veprën, shumë të ndryshëm nga arkaizmi i përkthimeve të mëparshme.¹⁶ Analiza teorike

13 CALDERÓN, *La vida es sueño*, Vepër e cituar, f. 77.

14 Përkthimi i tekstit është bërë nga autorja e punimit. Varianti i zgjedhur i gjuhës së përkthimit është ai që i afrohet gjuhës së Ndre Mjedjes, si më e afërt në ndërtimin e ritmit karakterial të gjuhës spanjole dhe funksionit të rëndësishëm të organizimit tingullor në vepër.

15 M. ARNOLD, vepër e cituar, f. 21, 23.

16 Po aty, f. 21.

e Arnold-it na sjell ndër mend përvojën e përkthimit në shqip të Homerit nga Gjon Shllaku në kulturën shqiptare, përvojë kjo e suksesshme edhe sot.

Në këtë pikëpamje të Arnold-it dhe duke gjykuar nga ky pikëvështrim, sistemin letrar shqiptar, vepra *Çeta e profetëve/Cuneus Prophetarum* e Pjetër Bogdanit (1625 – 1689) dhe, proza e përpunuar e saj, pasuria gjuhësore dhe shprehjet frazeologjike të Ligjëratave për të vijuar edhe me pjesët ilustruese poetike të saj, të përkthyer apo krijime origjinale,¹⁷ të cilat i përgjigjen edhe nga pikëpamja e gjinisë disi dramës poetike të Pedro Calderón-it, janë jo vetëm bashkëkohëse me veprën e autorit spanjoll, po ashtu edhe e poetikës baroke.¹⁸

Duke u ndalur më në thellësi të veprës së autorit shqiptar lipset theksuar që *Çeta e profetëve (Cuneus prophetarum)* pjesa e parë dhe Jeta e Jezu Krishtit, shëlbuesit të botës (*De vita Iesu Christi, salvatoris mundi*) pjesa e dytë (1685), në tërësinë e saj i shërben përkthyesit si modeli gjuhësor i shprehësisë e poetikës baroke, qoftë për prozën me ritëm të shtruar e solemn, në qasjen e saj reflektive dhe të thelluar mbi temat e mëdha filozofike, fetare dhe shkencore, ashtu edhe për pasurinë shprehimore në përdorimin e figurave letrare si alegoritë, metaforat dhe simbolet biblike dhe ndërlikidhjen e mitologjisë me historinë të cilat i japin tekstit një dimension të thellë barok, të mbushur me ndërlikime semantike dhe stilistike të shprehjeve frazeologjike. E gjithë kjo lëndë gjuhësore qëndron përballë një veprë komplekse si *Jeta është ëndërr* e Pedro Calderón-it e cila veçohet për integrimin e muzikës, ndjeshmërinë skenografike, ndërlikimin e një strukture dramatike, që u quajt "*lopeske*"¹⁹ dhe që dallohet për reduktimin e personazheve, formësimin e komplotit rreth protagonistit kryesor dhe një gjuhë e përpunuar ku ndërthuret mjeshtëria e përshkrimit të mjedisit, natyrës, në funksion të caktuar dramatik. Për këtë, gjuha përshkruese metaforike ngërthen në vetvete shtresëzime biblike, mitologjike, historike

17 P. BOGDANI, *Cuneus Prophetarum de Christo salvatore mundi... Pars prima. - De vita Iesu Christi salvatoris mundi... Pars secunda*. Re. ex Typographia Seminarii. I. Vëll. e 1-2. Padova: Tipografia del Seminario di Padova, 1685. 2 vëll.

18 A. BERISHAJ, «Vepra e Pjetër Bogdanit dhe poetika e barokut» *STUDIME: Revistë për studime filologjike* 26 (2020): 201-210. Shih: "Te vepra e Bogdanit dimensionet e poetikës së barokut mund të shquhen te botëkupimi i përgjithshëm i saj, respektivisht *perspektiva kozmike mbi jetën* (Hauser 160), te koncepti mbi librin dhe zhanrin, te kompozicioni dhe lidhjet me onirizmin, te alegoria dhe shumëfishësia simbolike, tiparet narrative e deskriptive *teatralizuese*, te *topika* dhe dimensionet formale tipike për manierizmin dhe barokun." f. 202.

19 *Lopeske* – term që i referohet karakteristikave të veprave të dramaturgut spanjoll Lope de Vega. Megjithatë, teatri barok spanjoll arrin kulmin e tij me veprën e Pedro Calderón de la Barca-s, vepër e cila pason modelin dramatik të krijuar nga Lope de Vega në fund të shekullit të 16-të dhe fillim të shekullit të 17-të. Sado që më pak prodhimtare, krijimtaria dramatike e Pedro Calderónit, sipas kritikëve, është teknikisht më e përpunuar dhe arrin të përkryejë formulën dramatike *lopeske* të paraardhësit të tij.

për ta paraqitur madhështinë e natyrës si krijim hyjnor.²⁰ Në këto cilësi të barokut *kalderonian*, cilësia tjetër tekstuale e veprës së autorit barok shqiptar që orientohet drejt një proze reflektive dhe me tematikë fetare, është e rëndësishme për lëndën gjuhësore që ofron.

Një sfidë për përkthimin e veprës së Pedro Calderón-it, me model veprën e Pjetër Bogdanit, është sjellja dhe rikrijimi me lëndën gjuhësore të këtij të fundit, të një gjuhe të përpunuar dramatike në vargje, një përsosje strukturore e gjinisë, të veprës së autorit spanjoll. Modelet tek vepra e Bogdanit theksojmë që qoftë gjuha e veprës, qoftë filozofia dhe teologjia që janë prijëse të shkrimit të saj, kanë një veçori domethënëse në kontekstin tonë. Vepër e cila, megjithëse përqendrohet në fjalën e shkruar, pra të menduar e të ndërmenduar, ndryshe nga *E Mbsuame e Krështerë* [*Dottrina Cristiana*] (1592) e Lekë Matrëngës që është e orientuar nga fjala e folur, ndërton një ligjërim reflektiv, i cili shquhet për intensitet dhe ritëm rrëfimi dhe pikërisht për këtë është i vlerësueshëm si lëndë gjuhësore qoftë në sintaksën që ndërton, qoftë në leksikun dhe shprehësinë që e përbën. Elemente aspektorë të shkrimit, ndërthurja e konceptit shpirtëror të të menduarit dhe përfytyrimi me përshkrimin konkret e bëjnë frymën poetike të shprehësisë baroke shqiptare në veprën e Bogdanit që mbështetet në prozodi e poetikë kryesisht në poezinë e ilustruar të përkthyer dhe atë të krijuar apo të përshtatur, të vlefshme si modele të veprës baroke spanjolle.²¹

Mirëpo, një vështirësi qëndron në përcaktimin e veprës si lënda bazë gjuhësore për përkthimin e autorit spanjoll.

Së pari, përshtatja me gjininë letrare: tradita dramatike e teatrit poetik spanjoll, nuk ka gjegjësen e tij në autorët shqiptarë të shek. XVII dhe vepra e Bogdanit, në këtë aspekt përgjigjet me një lëndë të pasur gjuhësore në prozë dhe në poezi, por jo të teatrit poetik.

Së dyti, forma gjuhësore arkaike: vepra e autorit shqiptar nuk ka

20 E. R. CUADROS, « Pedro Calderón de la Barca. » D. T. GIES, *The Cambridge history of Spanish literature*. I vëll. Cambridge: Cambridge University Press, 2009., f. 265-268.

21 "*Cuneus prophetarum* merret si kryevepra e letërsisë së hershme shqiptare dhe është e para vepër me tipare të plota letrare e artistike në gjuhën shqipe. Ajo përfshin një gamë të gjerë: filozofi, teologji, shkencë (me trajtime në gjeografi, astronomi, fizikë e histori). Ndërsa me poezinë dhe prozën letrare të saj prek çështje të estetikës e të teorisë së letërsisë. Ajo është një vepër humaniste e *Epokës Baroke* e ndikuar nga traditat filozofike të Platonit, Aristotelit, Shën Agustinit dhe Shën Thoma Akuinit. Qëllimi filozofik themelor i Bogdanit është njohja e Zotit, zbërthimi dhe shpjegimi i problemeve të qenies, çka ai e kryen me armët e arsyes e të mendjes. Edhe pse talenti i Bogdanit bie më shumë në sy në prozë, poezisë së tij të thjeshtë fetare nuk i mungon eleganca. Trungun e poezisë së tij e përbëjnë vjershat për dhjetë Sibilat (e Kumës, e Libisë, e Delfit, e Persisë, e Eritresë, e Samosit, e Kumanit, e Helespontit, e Frigjisë, e Tivolit), vjersha që përshkohen nga prirja e shija baroke për tema fetare dhe aludime klasike." R. ELSIE, *Histori e letërsisë shqiptare*; Përkth. A. MYFTIU. Botimi i dytë. Pejë: Dukagjini, 2001, f. 42-43.

lexueshmëri të gjerë sot, për shkak të formave arkaike të shqipes dhe një tradite të pakët dhe të pa përgjithësuar në lexuesit shqiptarë të teksteve filologjike dhe të tejkshkruara ²² që ta bënin këtë veprë si edhe veprat e bashkëkohësve të tij komunikuese me lexuesin e sotëm, duke ndërtuar kështu një vetëdije mbi sistemin letrar dhe poetikën baroke shqiptare. Kujtojmë që M. Arnold-i, në veprën e tij, ndërsa merrte në shqyrtim përkthimin e Homerit në gjuhën angleze të deriatëhershme, nga ai i George Chapman-it (1559–1634), tek John Dryden-i (1631–1700), të cilët përkthejnë në vargje të bardha miltoniane dhe Alexander Pope (1688–1744) dhe William Cowper (1731–1800) të cilët sjellin një përkthim në vargje më afër poetikës së tyre se sa vetë teksti homerik²³, vinte në dukje edhe një arkaizëm të vargjeve të përkthyer homerike dhe një ngadalësi në ndërtimin e ritmit të të rrëfyerit të tyre gjë që nuk përkon me rrëfimin homerik,²⁴ dhe për këtë arsye sugjeronte kërkimin e një ligjërimi poetik, lokal popullor për ritëm më të natyrshëm e të freskët, si model poetik. Nga ana tjetër, vepra e autorit spanjoll Pedro Calderón me gjithë kompleksitetin barok është lehtësisht e lexueshme nga lexuesi - spektatori i sotëm spanjoll, ndërsa nuk ndodh kështu me veprën e Bogdanit, lexueshmëria e të cilit sot është e kufizuar në një rreth të ngushtë studiuesish dhe vetëm për studime gjuhësore. Për përkthyesin e veprës së Pedro Calderón-it, vepra e Bogdanit dhe gjithë lënda gjuhësore e shprehësia e saj baroke, lipset përdorur në përkthim duke e sjellë me kujdes në format e sotme, pa humbur frymën, ritmin e të menduarit bogdanian. Në përfundim theksojmë që vepra e P. Bogdanit apo edhe ajo e Pjetër Budit²⁵ është një model poetik i shprehësisë

22 Një traditë të vyer në studimet filologjike dhe tejkshkrimin e veprës së Bogdanit e gjejmë tek tejkshkrimi i Mark Harapit (1940) dhe ai i Anila Omarit (2015) shih: P. BOGDANI, *Cuneus Prophetarum [a se] [Çeta e Profetve] : n'alfabetin e soçëm e kthiellue me vrojtime ... prej Mark Harapi*. Shkodër: Shtypshkronja e Zojës s'Paperlyeme, 1940 dhe P. BOGDANI, *Cuneus Prophetarum (Çeta e Profeteve); botim kritik me një studim hyrës, faksimile të origjinalit, transkriptim e shënime* nga Anila Omari, Tiranë: Akademia e Shqipërisë, 2015.

23 M. ARNOLD, vepër e cituar, f. 49, 50-53

24 Po aty, f. 94-96.

25 Shih: Z. NEZIRI, *Vjershërimi i Jul Varibobbës*. Shkup: Logos-5, 2008, f. 26, cit: “Kështu, Budi duke afirmuar parimet e Barokut religjioz të kohës, merret me përshkrimin e pendestarit, të frikës, të reminishencës së mëkatit, të ambientit të shkretëtirës dhe të egërsisë natyrore, në të cilat gjallon mëkatari; të mohimit të jetës dhe të gjithçkaje jetësore përballë vdekjes; të asgjësimit të bukurisë fizike dhe natyrore përballë bukurisë hyjnore, kozmogonike e qiellore. Prandaj në vjershat e tij pas secilit varg, përveç momenteve kur përshkruhet lindja e Krishtit (ku ndihet drita dhe shkëlqimi), përshkruhet terri, errësira, nata, vdekja, mohimi i gjithçkaje të prekshme për hir të apostrofimit të qiellores. Këto motive përshkrimore të botës poetike të personazhit biblik janë kërkesa të përgjithshme të letërsive evropiane, si të asaj angleze, franceze e gjermane, ashtu edhe të asaj italiane, portugeze e spanjole të Barokut religjioz. Në këtë kontekst edhe Budi nuk bën përjashtime.”

baroke në kulturën shqiptare, që mund të shërbejë si lëndë gjuhësore për përkthimin e veprës së autorit barok spanjoll, Pedro Calderón, *Jeta është ëndërr*, por jo e mjaftueshme dhe as e vetmja. Në kushtet e një përkthimi të sotëm dhe të parë të një vepre të tillë, lipset kërkuar më tej për modele poetike të shqipes.

4.2. Modeli poetik Mjedjan

Ndërsa vepra e Pjetër Bogdanit paraqitet një model arkaik edhe pse përkues në poetikë për përkthimin e një vepre të poetikës baroke të Pedro Calderón-it, *Jeta është ëndërr*, dhe jo e receptueshme për lexuesin e sotëm, pra ka nevojë për pëpunim; një autor tjetër i kulturës shqiptare, por i një periudhe tjetër të letërsisë, neoklasiku Ndre Mjedja (1866-1937), me veprën e tij *Ândra e jetës* (1917), afrohet, për shkaqe të tjera, si model poetik me poetikën baroke të Pedro Calderón de la Barca-s.

Kjo vepër është po aq komplekse në sistemin letrar shqiptar sa është komplekse vepra e autorit spanjoll dhe ndryshe nga vepra e autorit barok shqiptar, Bogdanit, afrohet me veprën që përkthehet edhe për nga kompleksiteti i gjinisë letrare. Vepra e Mjedjes shënon të njëjtin kompleksitet për sa i përket këtyre karakteristikave; është një poemë “rrëfimtare me subjekt të qartë dhe personazhe të vizatuar me thellësi, ku mbizotëron objektiviteti.”²⁶ “Autori ka kapërcyer edhe romanticizmin edhe prirjen neoklasiciste.”²⁷ Megjithëse poemë, e një intensiteti të rrallë poetik, “Lirizmi është i pranishëm vetëm si rrymë e nëndheshme që rrjedh në thellësi.”²⁸ Cilësitë e veprës të vëna re edhe nga studiuesi Giuseppe Gradilone, dalin në pah nëpërmjet këtyre konstatimeve: “vepër me karakter universal”,²⁹ por që ngërthen në të një “...problematikë shoqërore, një problematikë ekzistenciale, një shtrim i problemeve si kuptimi i jetës, i dashurisë, i dhimbjes dhe i vdekjes.”³⁰ Përfundimisht, studiuesja Klara Kodra e përkufizon poemën si: “shoqërore-psikologjike, me elementë të poemës filozofike.”³¹ Ndërlikueshmërisë në shprehësi, tematika e lojë dramatike të ngërthyer në një vepër të teatrit poetik spanjoll i përgjigjet në shqip një vepër e ndërlikuar për nga përcaktimi i gjinisë. Duke iu referuar karakteristikave të gjinisë së veprës së Mjedjes, studiuesja Klara Kodra vëren se ajo mund të emërohet: “Roman në vargje, roman i formimit,

26 K. KODRA, «Mendime mbi veçoritë gjinore të poemave të N. Mjedjes.» *Mjedlogji 1* 2014: 111-119.

27 Po aty.

28 Po aty.

29 G. GRADILONE. «La poesia del Miedia: Svolgimento e modelli letterari.» Gradilone, Giuseppe. *Studi di letteratura albanese*. Roma, 1960.

30 K. KODRA, *Mjedlogji 1*, 2014: 111-119.

31 Po aty.

vepër polimetrike, poemë epiko-lirike, poemë liriko dramatike.”³² Ndërkohë është ky kompleksitet i veprës që ka bërë që studiuesit ta vendosin Ndre Mjedjen në periudha e drejtime të ndërthurura, ndërthurje që anon nga një realizëm dhe modernizëm. Klara Kodra në studimin e saj përcakton tre drejtime letrare: romantizmin, neoklasicizmin dhe realizmin.³³ Dhe, po për këtë arsye, ndërsa ndalet tek aspektet e ligjëritit të veprës së Mjedjes, studiuesja Vjollca Osja, vë në dukje tek kjo vepër e tij, kompleksitetin e artit të Mjedjes, veçon elegancën dhe harmoninë tingëllore të veprës së tij poetike e realizuar sipas “një ndërtimi me saktësi matematikore.”³⁴ Këto veçori të tekstit poetik të veprës së Mjedjes edhe pse jo të poetikës baroke si ajo e Bogdanit e bëjnë atë një model poetik përkues në kulturën shqiptare, për sjelljen në shqip të një vepre po kaq komplekse sa *Jeta është ëndërr* të Pedro Calderón-it, model poetik i cili për më tepër, përveç se trajton në veprën e tij, mitema të njëjta me autorin spanjoll si *ëndrra, jeta dhe vdekja*, është vijues i poetikës baroke në sistemin letrar shqiptar dhe më afër lexuesit të sotëm me veprën e tij.

5. Teksti midis *somnus* e *oneiros*

Natyrisht, për të sqaruar e kuptuar më mirë anën kuptimore të thelbit ekzistencial, jehonës me mitin e Edipit, lidhjes me letërsinë baroke, poetikën e saj, natyrën e përpunimit të gjuhës, figuracionin të veprës së Pedro Calderón-it lipset të thellohem më tej në teksturën saj dhe shprehësinë që kjo krijon në të.

Në këtë pikëpamje një element që lipset pasur parasysh është koncepti *ëndërr* i trajtuar në veprën e Pedro Calderón-it, si një nga mitemat më domethënëse të poetikës baroke, në shtrirjen e saj shumëplanëshe, konceptin teologjik, *jeta është ëndërr* dhe projektimin e saj në jetën tokësore të Segismundit. Kjo nuk lihet pa u përmendur në lidhje me shprehësinë që krijon në veprën origjinale, përkthimi i të cilës përballet në rradhë të parë me qasjen sistimore ndaj *ëndrrës/ ândrës* në shqip.

Pikërisht, këtu hyn në skenë përvoja dhe shprehësia e krijuar në këtë kontekst në shqip nga autori shqiptar Ndre Mjedja. E prej këndeje edhe vëmendja që i duhet kushtuar, përbërësve kuptimorë që ndërton fjala *ëndërr* në dy gjuhët respektive, të projektuara në dy veprat e autorëve, prej të cilave është aq komplekse poetika baroke e Pedro Calderónit në kuptimet që sugjeron.

Vepra e Ndre Mjedjes është e rëndësishme për sjelljen në shqip të një

32 Po aty.

33 Po aty.

34 V. OSJA, *Aspekte të ligjëritit në poezinë e Mjedjes, Poradecit, Nolit dhe Migjenit*. Tiranë: ELVE, 2014. f. 29, 149. <www.elve.al>.

vepre të *Shekullit të artë* të letërsisë spanjole, Pedro Calderón de la Barca, sepse ai shkroi një vepër gati homonime, e cila poetizon konceptin e *ëndrrës/ândrës* në shqip, mitemë thelbësore në të dy veprat dhe me këtë vë në punë gjithë përfytyrimin poetik, të ndërtuar në gjuhën shqipe me *ëndrrën/ ândrën*.

Po t'i kthehemi veprës së Pedro Calderón-it, vepra e konsideruar nga kritika si serioze, ka në qendër një monolog dramatik të personazhit kryesor atë të Segismondit, mbi persiatjet ekzistenciale të të cilit zhvillohet e zgjerohet tema e *ândrës / sueño*. Pikërisht këtu, ngjashmëria nuk është me doemos lehtësi në procesin e përkthimit, sepse çdo njësie kuptimore e imaginative që zhvillohet e krijohet në veprën e autorit spanjoll, (shih tekstin e sjellë më sipër), nuk i përgjigjet e njëjta njësi kuptimore e përfytyrim në gjuhën mbërritëse. Për të kuptuar këtë dallim përfytyrimi lipset të thellohem në shprehësinë e etimologjinë e fjalës *ândërr/ëndërr/sueño* në dy gjuhët përkatëse.³⁵

Teksti poetiko-dramatik *kalderonian* ka si shprehësi themelore ndryshimin thelbësor të fjalës ("*sueño*": *soñar / soñar*)= *ëndërr: me ëndërrue/ëndërrim* si një proces gjumi ose një lloj i veçantë imagjinate, kur njeriu krijon në mendje imazhe, ide etj., gjatë këtij procesi (kuptimi i parë) si edhe (*sueño/soñar*) = *ëndrrën/ ëndërrimin* për diçka, që dëshiron të përmbushë në të ardhmen, imagjinatë, me vlerë figurative, metaforike, simbolike, (kuptimi i dytë). Ky sinkretizëm i kuptimit figurativ me atë konkret të procesit të gjumit, "ndihmohet" nga vetë etimologjia e fjalës (*sueño / soñar*) e cila shënon si procesin e gjumit ashtu edhe atë të të ëndërruarit.³⁶ Kjo ka ndikuar që të përvijohet në të gjithë veprën kjo ndërthurje si shprehësi, e cila përkon me estetikën baroke në lidhje me *ëndrrën* tek autori spanjoll.

Në këtë kontekst varianti poetik në gjuhën mbërritëse, në shqip, në lidhje me poetizimin e *ëndrrës* sipas modelit të zhvilluar/poetizuar nga vepra e Ndre Mjedjes, paraqitet sa i rëndësishëm aq edhe sfidues. Ndërsa

35 J. COROMINAS, *Breve diccionario etimológico de la lengua castellana*. Re. DAMASO ALONSO. Tercera edicion. Madrid: Gredos, 1987, f. 547. "La palabra *sueño* (del latín «somnus», que se conserva en los cultismos somnífero, somnoliento y sonámbulo) designa tanto el acto de dormir como la actividad de la mente durante ese periodo de descanso. Es una función natural del cuerpo humano, una de las más importantes y con mayor necesidad."

36 Shih: J. COROMINAS, 1987, p. 546: SUEÑO, h. 1140. Del lat. SÖMNUS 'acto de dormir', con el cual vino a confundirse en cast. el lat. SÖMNĪUM 'representación de sucesos imaginados durmiendo'. DERIV. *Soñar*, h. 1140; *soñación; soñador; sueñera. Soñoliento*, 1490; *soñolencia o somnolencia*, S. XVI. *Ensueño*, 1580, imitación del lat. INSOMNIUM íd., que a su vez es imitación culta del gr. *enýpnion* íd.; *ensoñar*, palabra rara, SS. XIII y XVI-XVII. Cultismos: *Insomnio. Insomne*. Del gr. *hýpnos*, equivalente del lat. *somnum: Hipnosis; hipnótico; hipnotismo; hipnotizar*. CPT. *Sonámbulo*, S. XIX; *sonambulismo, Somnífero*.

nuk ekziston një vepër e bashkëkohëse me Pedro Calderón de la Barca-n e poetikës baroke në letërsinë shqipe që të poetizojë *ëndrrën* dhe autori i letërsisë së vjetër shqipe, që i përket kësaj periudhe, Pjetër Bogdani vepra e të cilit ofron gjithë lëndën gjuhësore e shprehësinë baroke të kohës në shqip, por nuk ka një vepër të plotë poetike, veç pjesë ilustruese dhe ciklin e sibilave; vetë vepra e Ndre Mjedjes konsiderohet si vazhduese dhe bartëse e kësaj tradite të pasur poetike në letërsinë shqipe.³⁷ Prandaj le ta shqyrtojmë këtë vepër në këtë kontekst, si poetizim i ëndrrës. Vepra e Ndre Mjedjes, në lidhje me trajtimin e poetizimit në ëndrrës dhe realitetit, jetës, idilit, dashurisë etj, shërben si model poetik me të cilin mund të punohet, si lënda poetike shqipe për përkthimin e veprës së Pedro Calderón de la Barca-s.

Pikërisht këtu, lipset të ndalemi në shprehësinë që ndërton fjala *ëndërr/ândër* në shqip, për t'i krahasuar e përqasur me ato në gjuhën spanjole dhe organizimin e poetikës baroke në veprën e autorit spanjoll. Në aspektin krahasimor, përbërësit semantikë që mbartin fjalët *sueño*(sp.) dhe *ândër / ândra* (shq, geg), të cilat dallojnë thelbësisht kuptimin që ndërtojnë dy fjalët në tekstet përkatëse (spanjisht – shqipen geqe).

Ndërsa *sueño*(sp.), etimologjikisht, një fjalë me origjinë latine *somnus*, mbart edhe kuptimin e ëndërrimit edhe të gjumit, kështu që përcakton/emërton si aktin e gjumit ashtu edhe veprimtarinë e mendjes gjatë asaj periudhe pushimi,³⁸ në shqip (varianti geg i veprës së Mjedjes), fjala *ândërr*, ndërsa është më afër etimologjikisht me fjalën greke *ὄνειρος* (oneiros) - *ândërr*, me kuptimin e një ëndrre të rreme,³⁹ nuk bart kuptim morfologjikisht të lexueshëm të *ândrrës/ëndrrës/ ëndrra* me *gjumin/ ëndrrën*, prandaj edhe nuk është receptuar si e tillë nga lexuesi shqiptar.⁴⁰

37 I. RUGOVA. *Kritika, Tekste të zgjedhura. (5-8), Botime të veçanta LXXX, SGJL 35*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2007., f. 564.

38 J. COROMINAS, 1987, p. 546: SUEÑO, h. 1140.

39 A. M. BYRD, «Deriving Dreams from the Divine: Hittite *tesha-/zash(a)i-*. 124, 96–105. » *Historische Sprachforschung / Historical Linguistics*, 124 (2011): 96-105. <<http://www.jstor.org/stable/41553566>>. Në gjuhët Indoeuropiane (IE) janë dy fjalë rrënjë që më shpesh japin burimin e fjalës '*ëndërr*'. E para, dhe e vërtetuar më plotësisht është **swep-* '*fle/gjumë*', e vijuar nga p.sh., Gk. *hýpar* 'Ëndrra e vërtetë, vizion, ecje në re', OE *swefn* 'gjumë dhe ëndërr' dhe OCS *sünije* 'ëndërr'. Rrënja e dytë, **h3en-*, gjendet vetëm në fjalën prej emërore **h3eni* 'ëndërr', që vërtetohet në greqishten (*ónar ~ óneiros* ' (ëndërr e rreme), armenishten (*anurj* 'ëndërr' < **h3nōryo-*) dhe me shumë mundësi në shqipen (*ëndërr* 'dream'). Shih edhe: VLADIMIR E. OREL, *Albanian etymological dictionary*. Boston: Brill, 1998., f. 92. në : ëndërr ~ andërr f, pl. *ëndrra ~ andrra* 'dream, sleep'. Continues PALb **anrja* with an epenthetic -d-. Identical with the Indo-European word for sleep **oner-* (Gk ovap) ~ **onerio-* (Gk oveipov, ovetpoc, Arm *anurj*), cf. CAMARDA I 38; MEYER Wb. 11, Alb. St. III 66.

40 J. POKORNY, *Proto-Indo-European Etymological Dictionary*. Re. G. STAROSTIN dhe A. LUBOTSKY. Revised and Published by the Dnghu Association. Indo-European Language

Kjo ka kushtëzuar receptimin e parë të veprës, atë në krahasimin me veprën e Ndre Mjedjes, duke e parë gjithë përfytyrimin mbi ëndrrën e të ëndërruarit, të kufizuar në kuptimet që shqipja ka ndërtuar në këtë kontekst. Përkthyesi, në këtë pikë lipset të shtyhet më tej e të ndërtojë një shprehësi që parashikon këtë kuptimësi të dyfishtë gati antonimike, mes ëndrrës dhe zhgjëndrës.

Po kështu, shqipja mund të krijojë atmosferën gjegjëse me *ândër* dhe *gjumë*, dy fjalë të ndryshme, të cilat do të duhet të ndërkëmbehen për të krijuar shprehësinë dhe paqartësinë, megjullën kuptimore që përkon me dyzimin ekzistencial të vetë personazhit në dialogun e monologun e tij. Për më tepër, fjala *gjumë* e shqipes, etimologjikisht lidhet me latinishten *somnus*, me greqishten e vjetër ὕπνος (*húpnos*), proto-sllavishten **snъ*), pra me rrënjën latine të fjalës *somnus*, që në një pjesë të gjuhëve europiane shënon sot fjalën *gjumë* dhe *ëndërr* si në spanjisht.⁴¹

Pra, lipset kërkuar në shprehësinë popullore shprehje e fraza të zhvilluara në rrjedhë të kohës të cilat të përkapin kuptime e të ndërtojnë shprehësi me këto dy fjalë *ëndërr* / *ândër* dhe *gjumë* për të sjellë në shqip poetikën baroke të Pedro Calderón-it.

Një fjalë tjetër, kuptimi i gjerë i së cilës në veprën e Pedro Caderón de la Barca-s nuk është sjellë me të njëjtën kuptim në shqip gjatë receptimit të parë të kësaj vepe është fjala *iluzion*. Në gjuhën spanjole ajo është fjalë me natyrë të dyfishtë dhe shënon, zhgënjimin, por edhe gazmendin e jetës, hutimin e saj..., ajo emërton *shpresë, përmbushja e së cilës duket veçanërisht tërheqëse*. 3. f. *Vetëkënaqësi e gjallëruese tek një person, një send, një detyrë*, etj.⁴² Fjala *ilusion*, ashtu si edhe *ëndërr* krijojnë atë shprehësi shestuese,

Association – , 2007. f. 2240. <http://dnghu.org/> . 14 3 2020. Page(s): 779. “Oner: English meaning: *dream* Deutsche Übersetzung: “Traum” Grammatical information: older r/n-stem Material: Arm. *anurj* “*dream*” (*onōr-jo-, compare Gk. τέκμαρ: τέκμαρ “mark, token, sign”); Gk. ὄναρ nom. acc. n. “*dream*” and adv. “*In dream*”; ὄνειρος, -ov, Eol. ὄνειρος, Cret. ἄναιρος (probably through influence der preposition ἄν-) “*dream*”, gen. Att. Ion. ὀνείρατος (originally *ὄνατος); Alb. gegh. ἄdërrë, Tosc ἔndërrë “*dream*” (onrjo-). Note: Common Alb. n > nd phonetic mutation References: WP. I 180, Meillet *Esquisse del*” Arm.2 150.”

41 J. POKORNY, *Proto-Indo-European Etymological Dictionary*, vepra e cituar, f. 2240. <http://dnghu.org/> . 14 3 2020. *gjumë* m ‘sleep’. From PAlb **supna* identical with a nominal derivative of IE **suep-* ‘to sleep’ - **sup* -no-: Gk ὕπνος ‘sleep’, Slav **спѣ* id. (Meyer Wb. 142, Alb. St. III 32). Shih edhe: V. E. OREL, *Albanian etymological dictionary*, vepra e cituar, f. 138. Alb. *gjumë* ‘sleep’, për-*gjumësh* ‘sleepy’ and Lat. *somnus* ‘sleep’ derived from a common root *supnos* but the phonetic shift Lat. p > mp > m is a typical Alb. not Lat. mutation. compare Alb. *Gheg* mesa (**nepōtiū*), Tosc *mbesa* “*niece*”. Clearly Lat. shared the same root with Illyr. Nga Proto-shqipja **supna*, nga Proto - Indoeuropianishtja **súpnos* (khs lat. *Somnus*, lituanishten *sāpnas*, greqishten e vjetër ὕπνος (*húpnos*), Proto-sllavishten **snъ*) e rindërtuar edhe si proto- shqipja **župnъh* -ë- ja moderne rrjedh nga Proto-Indoeuropiania *-ós si Proto-shqipja *- *uh*.

42 Española, Real Academia. *Diccionario de la lengua española*. Vigésima primera edición.

medituese e dyzuese, karakteristike për veprat e periudhës baroke, përfaqësuese e poetikës së të cilës është vepra *Jeta është ëndërr*.

Ndryshe paraqitet fjala në gjuhën shqipe, në fakt, jo rastësisht ka qenë një nga fjalët që ka orientuar keqinterpretimin e veprës, në receptimin e parë. Shqipja, po t'i referohemi *Fjalorit të gjuhës shqipe*, në tre kuptimet që paraqet, ruan të njëjtën kuptim të përgjithshëm për fjalën *iluzion*.

1. perceptim i shtrembëruar a i gabuar i sendeve, i dukurive etj. për shkak të të metave të shqisave ose të rrethanave të jashtme: iluzion pamor (optik).
2. kuptim i figurshëm; përfytyrim i shtrembër ose mendim i gabuar për dikë a për diçka, kur nuk e njohim mirë të vërtetën;⁴³

Prandaj, edhe për përkthyesin lind nevoja e një hulumtimi gjuhësor të thelluar jo vetëm në gjetjen e të barazvlefshmeve kuptimore shprehimore, por edhe në ndërtimin me lëndën gjuhësore shqipe të kësaj shprehësie baroke, e cila mbështetet në fjalë të tilla të cilat përmbledhin në gjuhë këtë dinamikë kuptimesh kaq të ndryshme.

6. Përfundime

Përkthimi i një vepre të tillë, si ajo e Pedro Calderón de la Barca-s, një figurë përfaqësuese e estetikës dhe poetikës baroke, është një ndërmarrje sa komplekse aq edhe sfiduese si për përkthyesin ashtu edhe për gjuhën mbërritëse. Po kështu, përkthimi i veprave të një shprehësie të dallueshme në kulturat përkatëse, siç është vepra *La vida es sueño* [*Jeta është ëndërr*] për *Shekullin e artë* dhe poetikën baroke spanjole, është një ngjarje për kulturën mbërritëse. Në rastin e marrë në shqyrtim, ndërsa për përkthyesin dhe përkthimin, nuk kemi një model të vetëm, strategjia parapërgaditore e përkthimit mbështetet në hulumtimin e shprehësisë së krijuar nga lënda e gjuhës mbërritëse që i përgjigjet poetikës baroke dhe karakteristikave kulturore të veprës. Si modele të shprehësisë baroke në kulturën shqiptare kemi gjuhën dhe shprehësinë shqipe të ofruar nga autorët shqiptarë: Pjetër Bogdani me veprën e tij *Çeta e Profetëve/ Cuneus Prophetarum* për gjithë

Madrid: Real Academia Española, 1992., f. 7070: **ilusión**. (Nga lat. illusio, -onis). 1. f. Koncept, imazh apo përfaqësim pa një bazë të vërtetë, i sugjeruar nga përfytyrimi ose shkaktuar nga mashtrimi i ndienjave. 2. f. Shpresë, përmbushja e së cilës duket veçanërisht tërheqëse. 3. f. Vetëkënaqësi, gjallëruese tek një person, një send, një detyrë, etj. 4. f. Retorikë. Ironi e gjallë dhe pikante.

43 J. THOMAI, M. SAMARA et al., *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006., f. 719. **iluzión**, -i emër i gjinisë mashkullore; numri shumë; -e(t) i ligjërimit libror; 1. perceptim i shtrembëruar a i gabuar i sendeve, i dukurive etj. për shkak të të metave të shqisave ose të rrethanave të jashtme: iluzion pamor (optik). 2. kuptim i figurshëm; përfytyrim i shtrembër ose mendim i gabuar për dikë a për diçka, kur nuk e njohim mirë të vërtetën; / shpresë e kotë që na gënjen, ëndërr e zbrazët: iluzionet e rinisë; s'ka iluzione.

lëndën gjuhësore që ofron vepra e tij, qoftë në prozë, ashtu edhe pjesët ilustruese poetike, origjinale ose të përkthyer dhe vepra e Ndre Mjedjes *Ândra e jetës* e cila përkton në shqip me veprën e autorit spanjoll, jo vetëm me poetikën baroke, por edhe me karakteristikat e një vepre komplekse, mjeshtërisë së vargëzimit, sinkretizimit, gjuhës metaforiko – simbolike dhe mitemat përkatese: ëndërr, vdekje, jetë.

Po kështu, përkthimi i veprave të tilla, përball gjuhën mbërritëse në shprehësinë dhe aftësinë përfytyruese që ajo ka krijuar, në këtë pikë, receptimet e para të veprës edhe pse të kontekstualizuara e interpretuara gabim, marrin rëndësi, sepse kështu ndihmojnë në një lexim më të thelluar kulturor të autorit spanjoll e veprës së tij si edhe vetëdijësojnë përkthyesin për shprehësinë e krijuar në gjuhën mbërritëse. Rasti i marrë në shqyrtim i fjalëve: *ëndërr*, *gjumë* dhe *iluzion*, na tregon jo vetëm kompleksitetin e gjuhës së autorit spanjoll, natyrën përfytyruese të gjuhës spanjolle dhe sfidës pasuruese të aktit të përkthimit për vepra të tilla, në gjuhën mbërritëse.

BIBLIOGRAFIA

- AHMETI, Isak. «Letërsia shqipe sipas G. Gradilonës.» *Fjala* 1971: 2.
- . «Ndre Mjeda dhe “Andrra e jetës”.» *Flaka e vëllazërimit*, 3, 5 11 1971: 20.
- . «Njëmendësia e iluzioni.» *Rilindja* 14 4 1973: 12.
- ARNOLD, Matthew. *On translating Homer with F.W. Newman's Homeric translation and Arnold's Last words*. London: George Routledge & Sons, 1905.
- BAYÓN, Miguel Zorita. *Breve historia del Siglo de Oro*. Madrid: Nowtilus, S. L., 2010.
- BERISHAJ, Anton. «Vepra e Pjetër Bogdanit dhe poetika e barokut.» *STUDIME: Revistë për studime filologjike* 26 (2020): 201-210.
- BOGDANI, Pjetër (1625-1689). *Cuneus Prophetarum [a se] [Çeta e Profetve] : n'alfabetin e soçëm e kthiellue me vrojtime ... prej Mark Harapi*. Shkodër: Shtypshkronja e Zojës s'Paperlyeme, 1940.
- BOGDANI, Pjetër dhe Anila Omari. *Cuneus Prophetarum (Çeta e Profeteve); botim kritik me një studim hyrës, faksimile të origjinalit, transkriptim e shënime*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2015.
- BOGDANO, Petro. *Cuneus Prophetarum de Christo salvatore mundi... Pars prima. - De vita Jesu Christi salvatoris mundi... Pars secunda*. Re. ex Typographia Seminarii. I. Vëll. e 1-2. Padova: Tipografia del Seminario di Padova, Candiani, Agostino, Gesuiti, 1685. 2 vëll.
- BUDI, Pjetër. *Vepra 1 [Dottrina Christiana/ Doktrina e krishterë (1618)]*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2022.

- BYRD, Andrew Miles. «Deriving Dreams from the Divine: Hittite tesḫa-/zash(a)i-. 124, 96–105. .» *Historische Sprachforschung / Historical Linguistics*, 124 (2011): 96-105. <<http://www.jstor.org/stable/41553566>>.
- CALDERÓN de la Barca, Pedro. *La vida es sueño*. Rungis Cedex: MAXTOR, 2017. <www.maxtorfrance.com>.
- COROMINAS, Joan. *Breve diccionario etimológico de la lengua castellana*. Re. Damaso Alonso. Tercera edición. Madrid: Gredos, 1987.
- CUADROS, Evangelina Rodríguez. « Pedro Calderón de la Barca.» Gies, David T. *The Cambridge history of Spanish literature*. first. I vëll. Cambridge: Cambridge University Press, 2009. 265-268.
- EKO, Umberto. *Emri i trandafilit*. Re. Gjergj Zheji. Përkth. nga origjinali Donika Omari. Tiranë: Elena Gjika, 1996.
- ELSIE, Robert. *Histori e letërsisë shqiptare*; . Përkth. Abdurrahman Myftiu. Botimi i dytë. Peja: Dukagjini, 2001.
- ESPAÑOLA, REAL ACADEMIA. *DICCIONARIO DE LA LENGUA ESPAÑOLA*. Vigésima primera edición. Madrid: Real Academia Española, 1992.
- GRADILONE, Giuseppe. «La poesia del Miedia: Svolgimento e modelli letterari.» Gradilone, Giuseppe. *Studi di letteratura albanese*. Roma, 1960.
- HAMITI, Sabri. *Ndre Mjedja*. Re. Nazmi Rrahmani. Prishtinë: Faik Konica, 2016.
- THOMAI, Jani; SAMARA, Miço; HAXHILLARI, Pavli; SHEHU, Hajri; FEKA, Thanasi; MEMISHA, Valter; GOGA, Artan. *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006.
- KODRA, Klara. «Mendime mbi veçoritë gjinore të poemave të N. Mjedjes.» *Mjedlogji 1* 2014: 111-119.
- . «Për një vlerësim sa më objektiv të veprës së Mjedës.» *Studime filologjike* 1.23 (1969): 165-174.
- MIEDIA, D. Ndre. *Juvenilia (Botim anastatik)*. Re. Dom Nikë Ukgjini. Lezhë: Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”, 2017.
- NEZIRI, Zeqirja. *Vjershërimi i Jul Varibobbës*. Shkup: Logos-5, 2008.
- NOVA, Zhaneta; KALLULLI, Adriatik; MALO, Foto. *Historia e letërsisë shqiptare 2*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1980.
- NUSHI, Admira. «A Comparative Overview Between the Duo Characters of Don Quixote Dela Mancha and the Rise and Fall of Comrade Zylo.» *World Journal of Education and Humanities* 3.1 (2021): 19-30. www.scholink.org/ojs/index.php/wjeh.
- OREL, Vladimir E. *Albanian etymological dictionary*. Boston: Brill, 1998.
- OSJA, Vjollca. *Aspekte të ligjërit në poezinë e Mjedjes, Poradecit, Nolit dhe Migjenit*. Tiranë: ELVE, 2014. <www.elve.al>.

- POKORNY, Julius. *Proto-Indo-European Etymological Dictionary*. Re. George Starostin dhe A. Lubotsky. Revised and Published by the Dnghu Association. Indo-European Language Association – , 2007. <http://dnghu.org/> . 14 3 2020.
- RUGOVA, Ibrahim. *Kritika, Tekste të zgjedhura. (5-8), Botime të veçanta LXXX, SGJL 35*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2007.

